

VENDIM
Nr.409, datë 22.4.2009

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.207, DATË 9.5.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PUNËVE TË VËSHTIRA OSE TË
RREZIKSHME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 84 pika 3, 90 e 100 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.207, datë 12.7.2002 të Këshillit të Ministrave, të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Punëdhënësit dhe punëmarrësit, me marrëveshje dypalëshe për këto vende pune, parashikojnë që kohëzgjatja maksimale javore e punës të mos kalojë 48 orë në javë, përfshirë në këtë kohëzgjatje edhe orët shtesë të punës.”.

2. Ngarkohet Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për kontrollin e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha